



Instituti i Kërkimeve Urbane

MIGRACIONI SHQIPTAR PAS VITEVE 90 DHE NDIKIMI I TIJ NË JETËN EKONOMIKE DHE SOCIALE TË FËMIJËVE TË LËNË PAS

Emigrimi jashtë Shqipërisë, pas viteve 90 ka përfshirë më shumë se 25 përqind të popullsisë dhe çfaqet i menjëhershëm, i vrullshëm dhe shpërthyes pas një ndalese 45 vjeçare. Emigracioni ka luajtur një rol të rëndësishëm në zbutjen e papunësisë dhe të varferisë përgjatë viteve të vështira të tranzicionit. Në 2007, remitancat përbënin 12 % të të ardhurës kombëtare dhe ishin 3 herë më të larta se investimet neto të huaja direkte. Në pjesën më të madhe të tyre remitancat janë përdorur kryesisht për të plotësuar nevojat bazë të familjeve përfituese. Megjithatë kjo struktura në vite ka ndryshuar dhe përdorimi i tyre për përmirësimin e kushteve të banimit dhe investimet në biznes, është në rritje.

Në fillim të lëvizjeve migratore, migrimi pa familjen ishte i natyrshëm. Duke qënë masiv, i paligjshëm dhe i kryer me mjete të rastit apo me kalim në këmbë të kufirit tokësor, ka dekurajuar shumë shqiptarë që të “aventurojnë” me gjithë familjen. Studimi i UNICEF në 2009 evidentoi 4,290 fëmijë të grupmoshës 0-17 vjeç me njërin ose dy prindërit në emigracion. Në vitet e para të emigracionit, ky numer ka qënë më i lartë, por legalizimi i statusit të emigrantëve, miratimi i politikave për ribashkimin familiar nga vendet e destinacionit kanë ulur ndjeshëm numrin e familjeve e fëmijëve të lënë pas. Pavarësisht kësaj, studimi i UNICEF në 2009, tregoi se numri i fëmijëve, të cileve ju mohohet e drejta për të jetuar me të dy prindërit, për shkak të emigracionit është ende i lartë. Këta fëmijë janë të përqëndruar në zonat rurale dhe rajonet që shtrihen në pjesën qendrore dhe atë bregdetare.

Në nivel familjeje, emigracioni dhe remitancat kanë ndikuar pozitivisht në rritjen e mirëqënies materiale. Krahasime ndërmjet familjeve me dhe pa emigrantë, tregojnë se varfëria është më e lartë tek grupi i dytë. Megjithatë ndikimi pozitiv në mirëqënien materiale nuk ka të njëjtin efekt edhe në mirëqënien emocionale. Ndarja e familjes për një kohë të gjatë dhe mungesa e babait në rritjen e fëmijëve është jo pa efekte negative. Ka një rritje të divorceve, ndonëse nuk ka evidenca se cili është shkak kryesor. Studimi ka evidentuar se fëmijët e lënë pas, manifestojnë probleme emocionale, ankth dhe depresion, në nivele më të larta se fëmijët në familjet me dy prindërit në Shqipëri. Zëvendësimi i përkujdesjes nga dy prindërit me vetëm njërin prej tyre, (nënë në 98 % të rasteve), bën që ky efekt të jetë më zbutur se sa në rastet kur të dy prindërit do të emigronin. Brënda fëmijëve me probleme emocionale, fëmijët më të rritur janë më të ndjeshëm. Niveli i ulët i remitancave, destinacioni i përdorimit të tyre, niveli i ulët i komunikimit dhe numri i vogël i vizitave të